



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË EDICION SPECIAL PËR SIGURINË PUBLIKE

KORRIK 2019





QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË
EDICION SPECIAL PËR
SIGURINË PUBLIKE

Botues: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Autore: Donika Marku

Redaktor i brendshëm: Mentor Vrajolli

Lektorimi: Kimberly Madsen

Versioni origjinal i këtij punimi është shkruar në gjuhën Angleze.

Prishtinë, korrik 2019 ©

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen me shkrim të botuesit. Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i asnjë materiali të botuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim të QKSS-së. Ju lutemi të kontaktoni: info@qkss.org ose +381 38 221 420. Perceptimet e paraqitura në këtë raport janë përmbledhje e përgjigjeve të marra nga të anketuarit dhe demonstrojnë vetëm mënyrën si i perceptojnë ata institucionet. Ky nuk është vlerësim përfundimtar i punës së institucioneve subjekt i këtij studimi. Raporti do t'u shërbejë si instrument për të adresuar mangësitë e mundshme, por edhe si tregues i efektivitetit të komunikimit të tyre me qytetarët. Pikëpamjet e paraqitura në këtë raport janë perceptimet e të anketuarve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë. Opinionet e shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e fondacionit National Endowment for Democracy (NED).

PËRMBAJTJA

MIRËNJOHJE	8
GJETJET KYÇE	9
HYRJE	10
KAPITULLI - PERCEPTIMET E QYTETARËVE DREJT KËRCËNIMEVE KRYESORE TË SIGURISË PUBLIKE	11
VRASJET	11
PLAÇKITJA E SHTËPIVE/ BANESAVE	14
FAJDET	17
DHUNA NË FAMILJE	19
NGACMIMET SEKSUALE	22
DHUNA NË SHKOLLA	25
AKSIDENTET E TRAFIKUT	27
QENTË ENDACAKË	29
KAPITULLI - PERIMETRI I SIGURISË	30
SHTËPIA	31
LAGJJA	34
QYTETI/FSHATI	37
KOSOVA	39
METODOLOGJIA	42
ÇKA ËSHTË BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË?	42

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Trendet në perceptimet publike të vrasjeve si kërcënim i lartë	11
Figura 2. Trendet në perceptimin publik të vrasjeve si kërcënim i lartë, sipas zonës	11
Figura 3. Trendet në perceptimin publik të vrasjeve si kërcënim i lartë, sipas rajonit	12
Figura 4. Trendet në perceptimin publik të vrasjeve si kërcënim i lartë, sipas përkatësisë etnike	12
Figura 5. Trendet në perceptimin publik të vrasjeve si kërcënim i lartë, sipas gjinisë	13
Figura 6. Trendet në perceptimin publik të vrasjeve si kërcënim i lartë, sipas moshës	13
Figura 7. Trendet në perceptimin publik të grabitjeve të shtëpive/banesave si kërcënim i lartë	14
Figura 8. Numri i rasteve të raportuara të grabitjeve gjatë viteve 2016, 2017 dhe 2018.	14
Figura 10. Trendet në perceptimin publik të grabitjeve të shtëpive/banesave si kërcënim i lartë, sipas zonës	15
Figura 9. Trendet në perceptimin publik të grabitjeve të shtëpive/banesave si kërcënim i lartë, sipas zonës	15
Figura 13. Trendet në perceptimin publik të grabitjeve të shtëpive/banesave si kërcënim i lartë, sipas moshës	16
Figura 11. Trendet në perceptimin publik të grabitjeve të shtëpive/banesave si kërcënim i lartë, sipas përkatësisë etnike	16
Figura 12. Trendet në perceptimin publik të grabitjeve të shtëpive/banesave si kërcënim i lartë sipas gjinisë	16
Figura 14. Trendet në perceptimin publik të fajdeve si kërcënim i lartë	17
Figura 15. Trendet në perceptimin publik të fajdeve si kërcënim i lartë, sipas zonës	17
Figura 16. Trendet në perceptimin publik të fajdeve si kërcënim i lartë, sipas rajonit	18
Figura 17. Trendet në perceptimin publik të fajdeve si kërcënim i lartë, sipas përkatësisë etnike	18
Figura 18. Trendet në perceptimin publik të dhunës në familje	19
Figura 19. Trendet në perceptimin publik të dhunës në familje si kërcënim i lartë, sipas zonës	19
Figura 20. Trendet në perceptimin publik të dhunës në familje si kërcënim i lartë, sipas rajonit	20
Figura 21. Trendet në perceptimin publik të dhunës në familje si kërcënim i lartë, sipas përkatësisë etnike	20
Figura 22. Trendet në perceptimin publik të dhunës në familje si kërcënim i lartë, sipas gjinisë	21
Figura 23. Trendet në perceptimin publik të dhunës në familje si kërcënim i lartë, sipas moshës	21
Figura 24. Trendet në perceptimin publik të ngacmimit seksual si kërcënim i lartë	22
Figura 25. Trendet në perceptimin publik të ngacmimit seksual si kërcënim i lartë, sipas zonës	22
Figura 26. Trendet në perceptimin publik të ngacmimit seksual si kërcënim i lartë, sipas rajonit	23
Figura 27. Trendet në perceptimin publik të ngacmimit seksual si kërcënim i lartë, sipas përkatësisë etnike	23
Figura 28. Trendet në perceptimin publik të ngacmimit seksual si kërcënim i lartë, sipas gjinisë	24
Figura 29. Trendet në perceptimin publik të ngacmimit seksual si kërcënim i lartë, sipas moshës	24
Figura 30. Trendet në perceptimin publik të rritjes së dhunës në shkolla si kërcënim i lartë	25
Figura 31. Trendet në perceptimin publik të rritjes së dhunës në shkolla si kërcënim i lartë, sipas zonës	26
Figura 32. Trendet në perceptimin publik të rritjes së dhunës në shkolla si kërcënim i lartë, sipas rajonit	26
Figura 33. Trendet në perceptimin publik të aksidenteve në trafik si kërcënim i lartë	27

Figura 34. Numri i aksidenteve në trafik sipas Policisë së Kosovës	27
Figura 35. Trendet në perceptimin publik të aksidenteve në trafik si kërcënim i lartë, sipas zonës	28
Figura 36. Trendet në perceptimin publik të aksidenteve në trafik si kërcënim i lartë, sipas rajonit	28
Figura 37. Trendet në perceptimin publik të qenve endacakë si kërcënim i lartë	29
Figura 38. Trendet në perceptimin publik të qenve endacakë si kërcënim i lartë, sipas zonës	29
Figura 39. Trendet në perceptimin publik të qenve endacakë si kërcënim i lartë, sipas përkatësisë etnike	29
Figura 40. Sa të sigurt ndihen të intervistuarit në shtëpinë, lagjen, qytetin/fshatin e tyre, dhe në Kosovë në përgjithësi	30
Figura 41. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në shtëpinë/banesën e tyre, sipas zonës	31
Figura 42. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në shtëpinë/banesën e tyre, sipas rajonit	31
Figura 43. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në shtëpinë/banesën e tyre, sipas përkatësisë etnike	32
Figura 44. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në shtëpinë/banesën e tyre, sipas gjinisë	32
Figura 45. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në shtëpinë/banesën e tyre, sipas moshës	33
Figura 46. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në shtëpinë/banesën e tyre, sipas hyrave mujore	33
Figura 47. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në lagjen e tyre, sipas zonës	34
Figura 48. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në lagjen e tyre, sipas rajonit	34
Figura 49. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në lagjen e tyre, sipas përkatësisë etnike	35
Figura 50. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në lagjen e tyre, sipas gjinisë	35
Figura 51. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në lagjen e tyre, sipas moshës	36
Figura 52. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në lagjen e tyre, sipas të hyrave mujore	36
Figura 53. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në qytetet/fshatrat e tyre, sipas zonës	37
Figura 54. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në qytetet/fshatrat e tyre, sipas rajonit	37
Figura 57. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në lagjen e tyre, sipas moshës	38
Figura 55. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në qytetet/fshatrat e tyre, sipas të hyrave mujore	38
Figura 56. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në qytetet/fshatrat e tyre, sipas gjinisë	38
Figura 58. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në Kosovë (niveli kombëtar), sipas zonës	39
Figura 59. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në Kosovë (niveli kombëtar), sipas rajonit	39
Figura 60. Sa të sigurt ndihen të anketuarit shqiptarë të Kosovës në Kosovë (niveli kombëtar)	40
Figura 61. Sa të sigurt ndihen të anketuarit serbë të Kosovës në Kosovë (niveli kombëtar)	40
Figura 62. Sa të sigurt ndihen të anketuarit pakicë jo serbë	41
Figura 63. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në Kosovë (niveli kombëtar), sipas gjinisë	41
Figura 64. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në Kosovë (niveli kombëtar), sipas moshës	41

MIRËNJOHJE

QKSS dëshiron t'u shpreh mirënjohje të veçantë anëtarëve të ekipit për kontributin e tyre të çmuar në hulumtimin në terren. Ekipi i BKS 2018 përbëhej nga:

BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË



GJETJET KYÇE

Rreziqet dhe kërcënimet kryesore ndaj komunitetit në Kosovë

- Ka një rritje të të anketuarve që i perceptojnë vrasjet si kërcënim kyç për sigurinë publike;
- Të anketuarit që jetojnë në zona urbane i perceptojnë vrasjet si një rrezik më të madh se qytetarët që jetojnë në zonat rurale;
- Të anketuarit ndihen më të kërcënuar nga grabitjet tani sesa gjatë dy viteve të mëparshme;
- Të anketuarit në zonat urbane ndihen më të kërcënuar nga grabitjet sesa qytetarët në zonat rurale;
- Fajdet po rriten me shpejtësi si kërcënim i perceptuar;
- Më pak se gjysma e të anketuarve e shohin rritjen e dhunës në shkolla si kërcënim për sigurinë publike;
- Më shumë se gjysma e të anketuarve i perceptojnë aksidentet e trafikut si kërcënim të lartë;
- Ka një rritje lineare të perceptimit të dhunës në familje si kërcënim të madh;
- Ka një rritje të qartë të perceptimit të dhunës në familje si kërcënim nga të dy gjinitë dhe të anketuarit e rinj janë më të shqetësuar për dhunën në familje;
- Shumica e qytetarëve nuk e perceptojnë ngacmimin seksual si rrezik të sigurisë publike;
- Më shumë se gjysma e të anketuarve i shohin kafshët endacake si kërcënim për sigurinë publike.

Trendet e Perimetrit të Sigurisë

- 4 nga 5 të anketuar raportuan se ndihen shumë të sigurt në shtëpitë/banesat e tyre.
- Nga viti 2016, 87 për qind e të anketuarve raportuan se ndiheshin të sigurt në shtëpi, duke ruajtur një trend të qëndrueshëm;
- Të anketuarit e rinj kanë raportuar se ndihen më të sigurt në shtëpi;
- Të anketuarat gra shprehën nivele pak më të larta të sigurisë në shtëpitë/banesat, lagjet dhe qytetet e tyre, në krahasim me meshkujt.
- Kur të anketuarit u pyeten nëse ndihen të sigurt në Kosovë një ndjenjë më e lartë e pasigurisë dhe e paqartësisë ishte e dukshme;
- Të anketuarit mbi 30 vjeç raportuan se ndihen më të sigurt në Kosovë sesa të anketuarit më të rinj;
- Të anketuarit shqiptarë dhe nga pakicat jo-serbe ndihen më të sigurt në Kosovë sesa qytetarët serbë.

HYRJE

Siguria është një e drejtë themelore e njeriut. Ndjesia e sigurisë apo e pasigurisë ndikon fuqishëm në shëndetin fizik dhe mendor dhe mirëqenien e qytetarëve¹ dhe mund të çojë në rritjen e besimit/mosbesimit, çka ndikon në socializimin e qytetarëve dhe ndjenjën e komunitetit.² Si rrjedhojë, QKSS-ja u ka kushtuar vëmendje të veçantë perceptimeve të qytetarëve në lidhje me sigurinë publike dhe sigurinë personale, që nga viti 2012 kur u lansua për herë të parë Barometri Kosovar i Sigurisë.

Ky edicion i posaçëm i BKS-së ofron një përmbledhje të perceptimeve të qytetarëve për sigurinë publike në Kosovë gjatë tri viteve të fundit. Më konkretisht, ai nxjerr në pah trendet e perceptimit mbi sigurinë publike, duke u fokusuar në të dhënat e Barometrit Kosovar të Sigurisë (BKS) të mbledhura gjatë periudhës 2016-2018. Të dhënat e mbledhura gjatë kësaj periudhe u përqendruan në shqetësimet dhe problemet kryesore të të anketuarve me sigurinë publike, si dhe në masat që duhen ndërmarrë për të përmirësuar sigurinë publike në Kosovë.

Elemente të ndryshme ndikojnë në perceptimet e qytetarëve në lidhje me sigurinë publike. Padyshim që qëndrimet e tilla formësohen nga përvoja personale. Megjithatë, nuk mund të injorohet rëndësia e mediave dhe rrjeteve sociale në formësimin e opinionëve të qytetarëve. Perceptimet mund të lidhen me karakteristikat personale të tilla si mosha, gjinia, përkatësia etnike, arsimi dhe gjendja ekonomike. Prandaj, përtej analizave të përgjithshme të të dhënave, ky edicion përfshin edhe analiza të kryqëzuara të kërcënimeve të ndryshme të sigurisë publike me karakteristika personale.

1 Stafford, M., Chandola, T., dhe Marmot, M., 2007, 'Lidhja ndërmjet frikës nga krimi dhe shëndetit mendor dhe funksionimit fizik', *Journal of Public Health*, 97 (11), f. 2076-2081

2 Healey, J. (2012) *Marrja e riskut dhe siguria personale*. Thirroul, N.S.W.: Spinney Press (Çështje në Shoqëri). I disponueshëm në: <http://search.ebscohost.com/login.aspx?direct=true&AuthType=ip,url,cookie&db=nlebk&AN=473049&site=ehost-live> (Qasur më: 19 prill 2019).

PERCEPTIMET E QYTETARËVE DREJT KËRCËNIMEVE KRYESORE TË SIGURISË PUBLIKE

Çdo vit, BKS-ja raporton për rreziqe të ndryshme ndaj sigurisë publike dhe personale. Ky raport përbëhet nga gjetjet në lidhje me vrasjet, plaqkitjet e shtëpive dhe banesave, fajdet, dhunën në familje, ngacmimet seksuale, dhuna në shkolla, aksidentet e trafikut dhe qentë endacakë.

VRASJET

Në vitin 2016, pothuajse 33 për qind e të anketuarve i perceptonin vrasjet si kërcënim kyç. Kjo ka rënë në 28 për qind gjatë vitit 2017. Megjithatë, në vitin 2018, kjo shifër u rrit në 35 për qind. Kjo rritje duket se lidhet me numrin e vrasjeve në vitin 2018.




Figura 1. Trendet në perceptimet publike të vrasjeve si kërcënim i lartë

Sipas Raportit Vjetor të PK-së për vitin 2018, në vitin 2018 numri i vrasjeve u rrit për 18 për qind, krahasuar me vitet 2016 dhe 2017, gjatë të cilëve ka pasur një rritje të lehtë prej 4 për qind për çdo vit.¹




Figura 2. Trendet në perceptimin publik të vrasjeve si kërcënim i lartë, sipas zonës

¹ Policia e Kosovës (2019) *Raporti Vjetor 2018* [Online] I disponueshëm në http://www.kosovopolice.com/repository/docs/RAPORTI_VJETOR_SHQIP.pdf (Qasur më 17 qershor 2019).




Figura 3. Trendet në perceptimin publik të vrasjeve si kërcënim i lartë, sipas rajonit




Figura 4. Trendet në perceptimin publik të vrasjeve si kërcënim i lartë, sipas përkatësisë etnike




Figura 5. Trendet në perceptimin publik të vrasjeve si kërcënim i lartë, sipas gjinisë




Figura 6. Trendet në perceptimin publik të vrasjeve si kërcënim i lartë, sipas moshës

PLAÇKITJA E SHTËPIVE/ BANESAVE

Trendi dominues tregon se qytetarët i perceptojnë plaçkitjet si kërcënim të lartë. Grafiku tregon qartë një rritje të dukshme të pasigurisë së qytetarëve në lidhje me këtë çështje. Në vitin 2016, 44 për qind e qytetarëve kanë raportuar se i perceptojnë grabitjet si kërcënim; në vitin 2018, më shumë se gjysma e të anketuarve (53 për qind) raportuan se e shohin këtë fenomen si kërcënim të konsiderueshëm. Në përputhje me këtë, duket se ka një korrelacion mes kësaj rritjeje të pasigurisë dhe rritjes së numrit të vjedhjeve dhe grabitjeve nga viti 2017 deri në vitin 2018.²




Figura 7. Trendet në perceptimin publik të grabitjeve të shtëpive/banesave si kërcënim i lartë

Viti 2018 u shënua nga raste të ndryshme të grabitjeve të bizneseve, bankave dhe shtëpive të banimit. Përveç kësaj, raste të ndryshme të grabitjeve të armatosura mund të kenë ndikuar në perceptimet e qytetarëve në lidhje me sigurinë personale dhe publike.




Figura 8. Numri i rasteve të raportuara të grabitjeve gjatë viteve 2016, 2017 dhe 2018.

2 Policia e Kosovës (2019) *Raporti Vjetor 2018* [Online] I disponueshëm në http://www.kosovopolic.com/repository/docs/Raporti_vjetor_i_pun%C3%ABs_s%C3%AB_Policis%C3%AB_s%C3%AB_Kosov%C3%ABs_2016_-_SHQIP.pdf (Qasur më 30 maj 2019).




Figura 9. Trendet në perceptimin publik të grabitjeve të shtëpive/banesave si kërcënim i lartë, sipas zonës



Figura 10. Trendet në perceptimin publik të grabitjeve të shtëpive/banesave si kërcënim i lartë, sipas zonës




Figura 11. Trendet në perceptimin publik të grabitjeve të shtëpive/banesave si kërcënim i lartë, sipas përkatësisë etnike




Figura 12. Trendet në perceptimin publik të grabitjeve të shtëpive/banesave si kërcënim i lartë sipas gjinisë

Gjatë dy viteve të fundit, qytetarët nën 30 vjeç ndihen më të kërcënuar nga plaçkitjet sesa qytetarët mbi 30 vjeç.




Figura 13. Trendet në perceptimin publik të grabitjeve të shtëpive/banesave si kërcënim i lartë, sipas moshës

FAJDET

Grafiku më poshtë tregon një rritje të shpejtë të perceptimit të fajdeve si kërcënim. Ndërkohë që në vitin 2016, 35% e të anketuarve deklaruan se i perceptonin fajdet si kërcënim,

në vitin 2018, 42 për qind e të anketuarve raportuan se i perceptojnë fajdet si kërcënim kyç.³




Figura 14. Trendet në perceptimin publik të fajdeve si kërcënim i lartë




Figura 15. Trendet në perceptimin publik të fajdeve si kërcënim i lartë, sipas zonës

3 Vini re se hulumtimi në terren u zhvillua para skandaleve të fundit të fajdeve të raportuara në media




Figura 16. Trendet në perceptimin publik të fajdeve si kërcënim i lartë, sipas rajonit




Figura 17. Trendet në perceptimin publik të fajdeve si kërcënim i lartë, sipas përkatësisë etnike

DHUNA NË FAMILJE

Ka një rritje lineare të perceptimeve të dhunës në familje si kërcënim. Ndërkohë që në vitet 2016 dhe 2017 vetëm 19 për qind e perceptonin këtë fenomen si kërcënim, në vitin 2018, 34 për qind e të anketuarve raportuan se e shohin dhunën në familje si kërcënim kyç. Kjo rritje mund të lidhet me rritjen e raportimit të rasteve të dhunës në familje nga mediat.⁴




Figura 18. Trendet në perceptimin publik të dhunës në familje

Po ashtu, në vitin 2018, pati një rënie prej rreth 12 pikë përqindjeje në të anketuarit që raportuan se nuk e shohin si rrezik dhunën në familje. Megjithatë, më shumë se gjysma e të anketuarve deklaruan se nuk e perceptojnë dhunën në familje si kërcënim për sigurinë.

Ka një rritje të madhe në perceptimin e dhunës në familje si kërcënim, si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale.




Figura 19. Trendet në perceptimin publik të dhunës në familje si kërcënim i lartë, sipas zonës

4 Marku, D., Emini, D. (2018) "Dhuna në familje dhe (mos) besueshmëria në Policinë e Kosovës" [Online] | disponueshëm në [http://www.qkss.org/repository/docs/KSB_Dhuna-ne-FamiljePDF_\(1\)_613475.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/KSB_Dhuna-ne-FamiljePDF_(1)_613475.pdf) (Qasur më 16 prill 2019).




Figura 20. Trendet në perceptimin publik të dhunës në familje si kërcënim i lartë, sipas rajonit




Figura 21. Trendet në perceptimin publik të dhunës në familje si kërcënim i lartë, sipas përkatësisë etnike

Ka një rritje të dukshme lineare në perceptimet e këtij fenomeni si kërcënim nga të dyja gjinitë. Përderisa që në vitin 2016 rreth 17 për qind e burrave perceptonin dhunën në familje si kërcënim, në vitin 2018, rreth 31 për qind e burrave e konsideruan si kërcënim të lartë. Kjo rritje ka qenë edhe më e dukshme tek gratë. Në vitin 2018, më shumë se 37 për qind e grave të anketuara deklaruan se dhuna në familje përbën një kërcënim serioz për to, çka paraqet një rritje me më shumë se 17 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. Po ashtu, ka një rënie në përqindjen e personave që nuk e perceptojnë dhunën në familje si kërcënim.

Ky trend rritës në perceptimet e dhunës në familje si rrezik, është shumë i rëndësishëm. Megjithatë, ndërkohë që ka një rënie në përqindjen e personave që nuk e perceptojnë

dhunën në familje si kërcënim, shumica e të anketuarve ende e shohin si rrezik të ulët. Në mënyrë të ngjashme, mungesa e korrelacionit mes të dhënave të policisë mbi rastet e dhunës në familje me përgjigjet e të anketuarve rezonon me pranimin tradicional të dhunës në familje dhe ngurrimin që të flitet për këto lloj çështjesh sociale. Ky pranim dhe ngurrim çojnë në mungesën e mbështetjes institucionale, çka rezulton në nën-raportim të rasteve të dhunës në familje.

Ka një rritje të dukshme të perceptimit të dhunës në familje si kërcënim, si në qytetarët nën 30 vjeç ashtu edhe ata mbi këtë moshë. Megjithatë, gjetjet tregojnë se qytetarët nën 30 vjeç janë më të shqetësuar për dhunën në familje sesa qytetarët mbi 30 vjeç.




Figura 22. Trendet në perceptimin publik të dhunës në familje si kërcënim i lartë, sipas gjinisë




Figura 23. Trendet në perceptimin publik të dhunës në familje si kërcënim i lartë, sipas moshës

NGACMIMET SEKSUALE

Trendi tregon një rritje të perceptimit të ngacmimeve seksuale si problem serioz në Kosovë. Në vitin 2016, 28 për qind e të anketuarve deklaruan se ata perceptonin ngacmimin seksual si kërcënim kyç për sigurinë e tyre personale. Ka pasur një rënie në perceptimin e ngacmimit seksual si kërcënim kyç për sigurinë personale në vitin 2017; megjithatë, në vitin 2018, 33 për qind e të anketuarve deklaruan se e perceptojnë ngacmimin seksual si kërcënim. Ndërkohë që ka një rritje prej pesë pikë përqindjeje në qytetarët që i perceptojnë ngacmimet seksuale si kërcënim, shumica e qytetarëve nuk e perceptojnë ngacmimin seksual si rrezik për sigurinë e tyre personale apo publike.

jithatë, në vitin 2018, 33 për qind e të anketuarve deklaruan se e perceptojnë ngacmimin seksual si kërcënim. Ndërkohë që ka një rritje prej pesë pikë përqindjeje në qytetarët që i perceptojnë ngacmimet seksuale si kërcënim, shumica e qytetarëve nuk e perceptojnë ngacmimin seksual si rrezik për sigurinë e tyre personale apo publike.




Figura 24. Trendet në perceptimin publik të ngacmimit seksual si kërcënim i lartë




Figura 25. Trendet në perceptimin publik të ngacmimit seksual si kërcënim i lartë, sipas zonës




Figura 26. Trendet në perceptimin publik të ngacmimit seksual si kërcënim i lartë, sipas rajonit




Figura 27. Trendet në perceptimin publik të ngacmimit seksual si kërcënim i lartë, sipas përkatësisë etnike

Një analizë e kryqëzuar e këtyre tri viteve tregon se burrat dhe gratë kanë mendime të ngjashme në lidhje me ngacmimin seksual dhe nga viti 2017 deri në vitin 2018 ka

pasur një rritje prej 7 pikë përqindjeje në të anketuarat gra dhe 10 pikë përqindjeje në të anketuarit burra që e perceptojnë këtë fenomen si kërcënim kyç.




Figura 28. Trendet në perceptimin publik të ngacmimit seksual si kërcënim i lartë, sipas gjinisë




Figura 29. Trendet në perceptimin publik të ngacmimit seksual si kërcënim i lartë, sipas moshës

DHUNA NË SHKOLLA

Gjatë periudhës 2016-2017, ka pasur raste të ndryshme të dhunës në shkolla. Gjatë kësaj kohe, ka pasur një trend rritës në perceptimin e dhunës në shkolla si kërcënim.⁵ Grafiku tregon një rritje graduale të përqindjes së të anketuarve që e shohin dhunën në shkolla si kërcënim; ndërkohë që në vitin 2016, 28 për qind e të anketuarve raportuan se e shihnin dhunën në shkolla si rrezik, në vitin 2017 kjo përqindje u rrit

në 31 për qind, dhe në vitin 2018 kjo përqindje u rrit në 34. Në përputhje me këtë, përqindja e qytetarëve që nuk e perceptojnë dhunën në familje si kërcënim ka rënë ndjeshëm gjatë vitit 2018. Marrë parasysh rëndësinë e sigurisë së fëmijëve, Policia e Kosovës e ka zgjeruar numrin e patrullave policore parandaluese për të shtuar sigurinë në shkolla.⁶




Figura 30. Trendet në perceptimin publik të rritjes së dhunës në shkolla si kërcënim i lartë

⁵ Hulumtimi në terren u zhvillua përpara rasteve të dhunës në shkolla të vitit 2019

⁶ Për të shtuar sigurinë në shkolla, PK-ja ka realizuar 18045 patrullime policore parandaluese në vitin 2016. Ky numër u ul në 14400 në vitin 2017. Sidoqoftë, në vitin 2018 numri i patrullimeve policore parandaluese u rrit në 35463. Për më shumë informata, lexoni raportet vjetore të PK-së për vitet 2016, 2017 dhe 2018.




Figura 31. Trendet në perceptimin publik të rritjes së dhunës në shkolla si kërcënim i lartë, sipas zonës




Figura 32. Trendet në perceptimin publik të rritjes së dhunës në shkolla si kërcënim i lartë, sipas rajonit

AKSIDENTET E TRAFIKUT

Ka një rritje lineare në përqindjen e qytetarëve që i perceptojnë aksidentet e trafikut si kërcënim kyç. Në vitin 2016, më shumë se gjysma e të anketuarve (53 për qind) raportuan se i shihnin aksidentin e trafikut si rrezik; në vitin 2018, 59 për qind e të anketuarve i raportuan aksidentet e trafikut si rrezik.

Nuk duket të ketë korrelacion mes numrit vjetor të aksidenteve dhe perceptimit të qytetarëve; ndërkohë që trendi tregon një rritje të perceptimit të këtij fenomeni si kërcënim kyç, numri i aksidenteve të trafikut të raportuara ka rënë në mënyrë lineare nga viti 2016 deri në vitin 2018.⁷




Figura 33. Trendet në perceptimin publik të aksidenteve në trafik si kërcënim i lartë




Figura 34. Numri i aksidenteve në trafik sipas Policisë së Kosovës

⁷ Për më shumë informata në lidhje me statistikat e Policisë së Kosovës për aksidentet e trafikut, ju lutemi lexoni tri raportet vjetore për vitet 2016, 2017 dhe 2018.




Figura 35. Trendet në perceptimin publik të aksidenteve në trafik si kërcënim i lartë, sipas zonës




Figura 36. Trendet në perceptimin publik të aksidenteve në trafik si kërcënim i lartë, sipas rajonit

QENTË ENDACAKË

Numri i qenve endacakë vazhdon të jetë një problem kyç i pazgjidhur në Republikën e Kosovës. Gjatë tri viteve të fundit, më shumë se gjysma e qytetarëve i kanë perceptuar qentë endacakë si kërcënim për sigurinë publike. Në vitin 2016, 55 për qind e qytetarëve i perceptonin qentë endacakë si kërcënim për sigurinë e tyre personale, ndërsa në vitin 2017 numri u rrit në 63%. Megjithatë, në vitin 2018, përqindja u ul në 59%. Në vitin 2018 u lansua projekti “Menaxhimi dhe kontrolli i qenve endacakë”, ku u aplikua metoda kapje-sterilizim-vaksinim-kthim (CNVR), si një mjet për të kontrolluar numrin e qenve endacak, por projekti përfundoi në dhjetor 2018. Prandaj, kjo rënie prej katër pikë përqindjeje në perceptimin e qenve endacakë si kërcënim mund të lidhet me këtë projekt. Kjo mund të tregojë se projektet si CNVR, të kombinuar me ngritjen e vetëdijes, janë të rëndësishëm për të kontrolluar numrin e qenve endacakë dhe perceptimet publike për ta.




Figura 37. Trendet në perceptimin publik të qenve endacakë si kërcënim i lartë




Figura 38. Trendet në perceptimin publik të qenve endacakë si kërcënim i lartë, sipas zonës




Figura 39. Trendet në perceptimin publik të qenve endacakë si kërcënim i lartë, sipas përkatësisë etnike

PERIMETRI I SIGURISË

Perimetri i sigurisë është një nga treguesit më të rëndësishëm të matur me edicionet e posaçme të sigurisë publike të BKS-së. Çdo vit, të anketuarit janë pyetur sa të sigurt ndihen në shtëpitë, lagjet, fshatrat e tyre, dhe në përgjithësi në Kosovë. QKSS-ja e përdor këtë instrument si mjet për hartëzimin e perimetrit virtual të sigurisë, si dhe për të identifikuar nivelet mikro dhe makro ku qytetarët ndihen të pasigurt, të sigurt dhe më të sigurt.⁸




Figura 40. Sa të sigurt ndihen të intervistuarit në shtëpinë, lagjen, qytetin/fshatin e tyre, dhe në Kosovë në përgjithësi

Gjetjet e tri edicioneve të fundit të BKS-së tregojnë se qytetarët kosovarë ndihen më të sigurt në shtëpitë/banesat e tyre. Një trend i qëndrueshëm i matur gjatë tri viteve të fundit tregon se më shumë se 85 për qind e të anketuarve ndihen shumë të sigurt në mjediset e tyre shtëpiake. Një trend i ngjashëm i qëndrueshëm vijon për lagjet, por me një rritje prej gati tri pikë përqindjeje nga viti 2017 deri në vitin 2018.

Duket se qytetarët janë më të shqetësuar për sigurinë e tyre kur ekspozohen në mjedise në makro-nivel, siç janë fshatrat, qytetet dhe Kosova në përgjithësi. Qytetarët raportuan se ndihen më pak të sigurt në fshatrat ose qytetet e tyre në krahasim me shtëpitë ose lagjet e tyre. Megjithatë, përqindja e të anketuarve që raportuan se ndihen të sigurt në qytetet/fshatrat e tyre po rritet gradualisht. Ndërkohë që në vitin 2017, rreth 75 për qind e të anketuarve raportuan se ndiheshin të sigurt, në vitin 2018, gati 79 për qind e të anketuarve raportuan se ndiheshin të sigurt në qytetet ose fshatrat e tyre.

Ndjenjat e paqartësisë dhe pasigurisë bëhen të qarta kur të anketuarit pyeten nëse ndihen të sigurt ose të pasigurt në Kosovë në përgjithësi. Ka një rënie prej dy pikë përqindjeje të qytetarëve që raportuan se ndiheshin të sigurt në Kosovë gjatë vitit 2018. Megjithatë, trendi tregon se nga viti 2017, më shumë se gjysma e të anketuarve kanë raportuar se ndihen të sigurt në Kosovë, krahasuar me vitin 2016, kur më pak se gjysma e qytetarëve raportuan se ndiheshin të sigurt.

Një analizë e kryqëzuar e të dhënave është e rëndësishme për të kuptuar dallimet në perceptimet e qytetarëve sipas përkatësisë etnike, gjinisë, rajonit dhe zonave urbane/rurale. Seksioni në vijim shqyrton secilin prej tyre.

⁸ Përfaqësimi vizual i të dhënave përqendrohet në përqindjen e sigurisë dhe jo të pasigurisë.

SHTËPIA

Rezultatet e BKS-së të tri viteve të fundit tregojnë se qytetarët që jetojnë në zonat urbane kanë tendencë të ndihen më të sigurt në shtëpi sesa qytetarët që jetojnë në zonat rurale. Në vitin 2016, 87 për qind e të anketuarve në zona urbane raportuan se ndiheshin të sigurt në shtëpi, duke ruajtur një trend të qëndrueshëm. Tek respodentët nga zonat rurale përqindjet janë pak më të ulëta kur raportojnë se ndihen të sigurt, me 84 për qind që raportojnë se ndihen të sigurt në shtëpi. Kjo përqindje u rrit në 86 për qind në vitin 2017, por u kthye në 84 për qind në vitin 2018.




Figura 41. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në shtëpinë/banesën e tyre, sipas zonës




Figura 42. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në shtëpinë/banesën e tyre, sipas rajonit




Figura 43. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në shtëpinë/ banesën e tyre, sipas përkatësisë etnike

Kur shqyrtohen tri vitet e fundit, gratë kanë tendencë të ndihen pak më të sigurta në shtëpi sesa burrat. Ndërkohë që trendi i raportimit të grave që ndihen të sigurta në shtëpi ka mbetur i qëndrueshëm në rreth 86 për qind, përqindja e burrave që raportojnë se ndihen të sigurt në shtëpi ra me pesë për qind gjatë vitit 2018.




Figura 44. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në shtëpinë/ banesën e tyre, sipas gjinisë

Duket se ekziston një lidhje mes moshës dhe ndjenjës së sigurisë/pasigurisë në shtëpi. Shumica dërrmuese e të anketuarve nën 30 vjeç ndihen më të sigurt në shtëpi sesa të anketuarit mbi 30 vjeç. Megjithatë, të anketuarit mbi 30 vjeç kanë raportuar se ndihen më të sigurt në Kosovë sesa të anketuarit më të rinj në moshë. Ky mund të jetë një tregues i mosbesimit të qytetarëve të rinj në një Kosovë të qëndrueshme dhe të sigurt, si dhe në një të ardhme të begatë për veten.




Figura 45. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në shtëpinë/ banesën e tyre, sipas moshës

Ne analizuam nëse të ardhurat mujore ndikojnë në perceptimet e qytetarëve në lidhje me sigurinë e tyre personale dhe publike. Në vitin 2017 pati një rritje të ndjenjës së sigurisë në shtëpi për të gjithë të anketuarit, përveç atyre që fitonin 120-250/muaj. Megjithatë, në vitin 2018 kjo përqindje ka rënë ndjeshëm. Kjo rënie është më e dukshme në qytetarët që kanë raportuar se fitojnë 500-800 në muaj (8 pikë përqindjeje) dhe më shumë se 800 në muaj (10 pikë përqindjeje). Kjo gjetje mund të ketë lidhshmëri me shtimin e numrit të vjedhjeve dhe grabitjeve të armatosura të përmendura më lart, të cilat pa dyshim kanë ndikuar në ndjenjat e qytetarëve për sigurinë.




Figura 46. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në shtëpinë/ banesën e tyre, sipas hyrave mujore

LAGJJA




Figura 47. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në lagjen e tyre, sipas zonës



Figura 48. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në lagjen e tyre, sipas rajonit




Figura 49. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në lagjen e tyre, sipas përkatësisë etnike

Trendi tregon se gratë kanë tendencë të ndihen më të sigurt në lagjen e tyre sesa burrat. Për më tepër, ka një rënie prej katër pikë përqindjeje të burrave që raportuan se ndiheshin të sigurt në lagjet e tyre.




Figura 50. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në lagjen e tyre, sipas gjinisë




Figura 51. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në lagjen e tyre, sipas moshës




Figura 52. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në lagjen e tyre, sipas të hyrave mujore

QYTETI/FSHATI

Në dallim nga gjetjet nga vitet 2016 dhe 2017, në vitin 2018, të anketuarit që jetojnë në zonat urbane raportuan se ndiheshin më të sigurt në qytetet/fshatrat e tyre sesa qytetarët që jetojnë në zonat rurale.




Figura 53. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në qytetet/fshatrat e tyre, sipas zonës




Figura 54. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në qytetet/fshatrat e tyre, sipas rajonit




Figura 55. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në qytetet/ fshatrat e tyre, sipas të hyrave mujore

Gjatë viteve 2017 dhe 2018 nuk ka pasur ndonjë ndryshim të konsiderueshëm në përqindje mes grave dhe burrave që raportuan se ndiheshin të sigurt apo të pasigurt në qytetet e tyre. Sidoqoftë, në vitin 2018 ka pasur një ndryshim prej tetë pikë përqindjeje, me gratë që raportojnë se ndihen më të sigurta në qytetet/fshatrat e tyre sesa burrat.




Figura 56. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në qytetet/ fshatrat e tyre, sipas gjinisë




Figura 57. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në lagjen e tyre, sipas moshës

KOSOVA

Çka mund të shihet qartë është se krahasuar me vitin 2016 ka një rritje në përqindjen e qytetarëve që raportojnë se ndihen të sigurt në Kosovë, si në zonat rurale ashtu edhe në ato urbane. Megjithatë, prej gati 2 pikë përqindjeje prej vitit 2017 në 2018. Ndërkohë në zonat rurale, si në vitin 2017 ashtu dhe në vitin 2018 ka pasur një rritje prej pesë pikë përqindjeje nga viti 2016.




Figura 58. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në Kosovë (niveli kombëtar), sipas zonës




Figura 59. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në Kosovë (niveli kombëtar), sipas rajonit

Në përgjithësi, gjatë gjithë periudhës 2016-2018, shqiptarët dhe pakicat jo-serbe raportuan se ndiheshin më të sigurt në Kosovë sesa qytetarët serbë. Ka pasur një rritje të konsiderueshme të besimit të të anketuarve shqiptarë të Kosovës, nga 50 për qind në 2016 në 56 për qind në 2017 dhe 2018. Në mënyrë korresponduese, ka një rritje lineare të ndjenjës së sigurisë brenda pakicave jo-serbë të Kosovës. Përkundrazi, ka pasur një rënie të fortë të ndjenjës së sigurisë në Kosovë brenda komunitetit serb të Kosovës. Përderisa në vitin 2016 34 për qind e të anketuarve raportuan se ndiheshin të sigurt, kjo përqindje ka rënë ndjeshëm në 2017 dhe 2018, me vetëm 14 për qind të të anketuarve serbë që deklarojnë se ndihen të sigurt në Kosovë.




Figura 60. Sa të sigurt ndihen të anketuarit shqiptarë të Kosovës në Kosovë (niveli kombëtar)




Figura 61. Sa të sigurt ndihen të anketuarit serbë të Kosovës në Kosovë (niveli kombëtar)




Figura 62. Sa të sigurt ndihen të anketuarit pakicë jo serbë




Figura 63. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në Kosovë (niveli kombëtar), sipas gjinisë

Grafiku tregon se gjatë periudhës 2016 dhe 2017 burrat kishin prirje të ndiheshin më të sigurt në Kosovë sesa gratë. Megjithatë, në vitin 2018 gratë kanë raportuar se ndihen pak më të sigurta në Kosovë sesa burrat. Po kështu, përqindja e burrave që u përgjigjën se ndiheshin të sigurt në Kosovë ra nga 57 në 51 për qind.




Figura 64. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në Kosovë (niveli kombëtar), sipas moshës

METODOLOGJIA

ÇKA ËSHTË BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË?

Barometri Kosovar i Sigurisë (BKS) është një program i veçantë i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) i krijuar në shtator të vitit 2012. Qëllimi i tij kryesor është që të mat besimin e publikut ndaj institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë në Kosovë si dhe të mat perceptimin e qytetarëve lidhur me kërcënimet e brendshme dhe të jashtme që i kanosen Kosovës.



BKS është aktiviteti i parë dhe më i madhi i këtij lloji i dizajnuar, zbatuar dhe komunikuar nga një forum lokal në Kosovë. Duhet theksuar se ajo që e bën unik BKS-në në Kosovë është neutraliteti i tij politik. Si një forum i pavarur, QKSS nuk ka kufizime politike në komunikimin e çfarëdo gjetjeje dhe mesazhi të hulumtimit.

BKS përdor kombinim të metodave cilësore dhe sasore që ofrojnë rezultate objektive dhe të besueshme. Të dhënat e tij mblidhen përmes intervistave personale me të anketuarit e përzgjedhur në mënyrë të rastësishme që zhvillohen nga hulumtuesit e QKSS-së në terren anembanë Kosovës. Pyetësi i QKSS-së përbëhet kryesisht nga pyetje të mbyllura në formë të Shkallës pesë-pikëshe të Likertit, që pasoheshin me disa pyetje të hapura që u mundësonin të anketuarve të japin mendimet e tyre pa u dhënë opsione të paracaktuara të përgjigjeve.

Ekipi i QKSS-së prej 28 hulumtuesve ka bërë pilotimin dhe intervistat. Mostra në nivel vendi nga të cilat u nxor ky hulumtim përfshinte 1,085 familje, duke përbërë kështu një mostër përfaqësuese të popullsisë mbi moshën 18 vjeçe në Kosovë.

Përkatësia etnike e personave të intervistuar ishte: 90 për qind shqiptarë të Kosovës, 8 për qind serbë dhe 2 për qind të tjerë (turq, boshnjakë, romë, ashkali, egjiptas, goranë, kroatë dhe malazez), që reflektonin përbërjen etnike të Kosovës.

Korniza e mostrës bazohej në zona sipas kodeve hyrëse telefonike dhe si e tillë përfshinte këto tetë rajone: Ferizajn, Gjakovën, Gjilanin, Mitrovicën Jugore, Mitrovicën Veriore, Pejë, Prishtinën dhe Prizrenin.




Faza e parë e grupimit gjeografik bazohej në Raportin e Regjistrimit të Popullsisë 2012. Faza e dytë përfshinte grupimin e mostrave për zona komunale me mostër të stratifikuar rurale/urbane sipas numrit të familjeve. Faza e fundit u zhvillua sipas metodës së caktimit të rastësishëm të mostrës duke përdorur ‘metodën e ditëlindjes’ më të afërt.

Caktimi i rastësishëm i mostrës siguron që secili banor i Kosovës të ketë gjasë të barabartë që të zgjidhet për intervistë. Me mostrën e zgjedhur për këtë studim, rezultatet e anketës pasqyrojnë trendët e qëndrimeve dhe perceptimeve në mesin e tërë popullsisë së rritur të Kosovës në përgjithësi.


Margjina e gabimit është 3 për qind me interval të besueshmërisë prej 95 përqind. Një intervistë testuese u zhvillua kah mesi i muajit shtator 2018 për të testuar sa është i plotë pyetësi para fillimit të punës në terren. Ekipi hulumtues pastaj raportoi se intervista testuese ishte e suksesshme dhe se nuk ishin hasur probleme me instrumentin testues. Të gjitha intervistat u kryen nga 29 shtator deri më 5 tetor 2018. Të dhënat u përpunuan dhe analizuan duke përdorur softuerin SPSS.

Perceptimet e paraqitura në këtë raport janë përmbledhje e informacioneve të marra nga të anketuarit dhe ai demonstroi se si njerëzit i perceptojnë institucionet kosovare.


Të anketuarit sipas gjinisë




Të anketuarit sipas vendbanimit



Hulumtimi në terren



Mosha



Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

351.746.1(496.51)(048)

Marku, Donika

Barometri Kosovar i sigurisë edicioni i posaçëm për sigurinë publike / Donika Marku.
– Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë Studies, 2019. - 48 f. : ilustr. me
ngjyra ; 21 cm.

ISBN 978-9951-679-94-7

www.qkss.org

ISBN 978-9951-679-94-7



9 789951 679947